



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

1894
23 05 2022

V E N D I M

Nr. 617, datë 22.9.2022

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.597,
DATË 4.9.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT
DHE TË MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS
EKONOMIKE DHE PËRDORIMIT TË FONDIT SHTESË MBI FONDIN
E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pikat 1 e 8, e 21, të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në kreun III, të vendimit nr.597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 7, 8 dhe 9, fjalët “... 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj ...” zëvendësohen me “... 9 900 (nëntë mijë e nëntëqind) lekë në muaj ...”.

b) Pas pikës 16 shtohen pikat 16/1, 16/2 dhe 16/3, me këtë përmbajtje:

“16/1. Gratë kryefamiljare, përfituese në programin e ndihmës ekonomike, që kanë në përbërje të familjes deri në dy fëmijë të moshës nga 0 në 18 vjeç, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.

16/2. Përfituesit e programit të ndihmës ekonomike, që kanë mbushur moshën 65 vjeç, të vetmuar, dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike.

16/3. Anëtarët e familjeve përfituese të programit të ndihmës ekonomike, që kanë mbushur moshën 65 vjeç dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.”.

c) Pikat 17 dhe 18 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“17. Masa e ndihmës ekonomike për familjet, që nuk përfitojnë sipas pikave 16/1, 16/2 dhe 16/3, të këtij kreu, rritet me dhjetë për qind më shumë të masës së pagesës ekzistuese, sipas strukturës së familjes.

18. Masa e ndihmës ekonomike sipas pikave 16, 16/1, 16/2, 16/3 dhe 17, të këtij kreu, përlllogaritet nga Shërbimi Social Shtetëror, bazuar në masën e pagesës ekzistuese, sipas strukturës së familjes, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 tetor 2022 dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELISDA BALLUKU

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

OGERTA MANASTIRLIU